



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 1056/4 Prot.

Tiranë, më 14/10/2013

Lënda: Rekomandim për "Klinika Dermatologjike Nakuçi Mikel", Tiranë

REKOMANDIM

Nr. 35, datë 14/10/2013

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organizative dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të raportit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit,

KONSTATOVA

Nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit, "Klinika Dermatologjike Nakuçi Mikel" Tiranë me objekt:

- Masat lidhur me sigurinë e të dhënave personale (neni 27).
- Plotësimi i formularit të njoftimit (neni 21).

Nga kontrolli administrativ u konstatua se:

Kontrolluesi "Klinika Dermatologjike Nakuçi Mikel" kryen aktivitetin e tij në kurimin e sëmundjeve dermatologjike dhe gjatë këtij aktiviteti mbledh dhe përpunon të dhëna personale për kategorinë "pacientë" gjatë vizitave që kryen.

Për kategorinë "pacientë" gjatë aktivitetit të tij kontrolluesi mbledh të dhëna personale si emri, mbiemri, diagnoza, të dhëna mbi alergjitë e mundshme. Këto të dhëna mblidhen nga kontrolluesi përmes plotësimit të kartelës së pacientit.

Qëllimi i mbledhjes dhe i përpunimit të të dhënave personale për pacientët është vetëm ofrimi i shërbimeve në fushën e dermatologjisë.

Në lidhje me objektin e kontrollit u konstatua se Kontrolluesi "Klinika Dermatologjike Nakuçi Mikel" nuk kishte realizuar detyrimin për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, në lidhje me këtë detyrim ligjor kontrolluesit ju la me proces-verbal detyrimi për plotësimin e Formularit të Njoftimit brënda 3 (tre) ditëve.

Gjithashtu, gjatë kontrollit u konstatua se të dhënat personale të klientëve mbaheshin për një afat të pacakuar. Për sa i përket kohës së ruajtjes së të dhënave personale sipas shkronjës d)

të pikës 1 të nenit 5 të ligjit, në të cilin përcaktohet se të dhënat personale nuk duhet të mbahen më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar. Në këtë rast duhet të respektohen afatet e parashikuara në kreun III "Ruajtja e të dhënave shëndetësore" të Udhëzimit nr. 23, datë 20.11.2012 "Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin e shëndetësisë". Kjo për të pasur historikun e ecurisë së sëmundjes dhe kurimit të pacientit në çdo kohë që atij mund ti rishfaqej sëmundja apo në rastet kur i duhej të rivizitohej pranë kontrolluesit (dermatologut).

Në kartelën e pacientit nuk u konstatua një pikë e veçantë në lidhje me detyrimin për informimin e pacientëve për fushën dhe qëllimin për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për mënyrën e përpunimit, për të drejtën për akses si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, ku citohet shprehimisht: "kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin,.....", si dhe në zbatim të Udhëzimit nr. 23, datë 20.11.2012 "Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin e shëndetësisë", kreun II "Regjistrimi i të dhënave shëndetësore për qëllime të kujdesit ndaj pacientit", pika 3.

Kontrolluesi "Klinika Dermatologjike Nakuçi Mikel" nuk ka një rregullore të shkruar për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë e të dhënave personale të klientëve, në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", ku citohet se: "Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat teknik-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin dhe rregullore të tjera"

Siguria e të dhënave

U konstatua se kontrolluesi përpunon të dhëna personale në rrugë elektronike përmes një kompjuteri të vetëm. Këtu përfshihen foto të atyre pacientëve që trajtohen vazhdimisht në klinikë, të grupuara në dosje/folder të veçantë me emrin e pacientit. Aksesin në këtë kompjuter e ka vetëm një person (përgjegjësi i klinikës). Kopje të këtyre të dhënave mbahen dhe në CD të veçantë, për të shmangur humbjen e tyre në rast defektesh apo fshirjesh aksidentale. Nuk ka përpunim të dhënash në rrjet. Masat e adaptuara të sigurisë (password, AV, CD backup) janë të mjaftueshme në këtë nivel përpunimi të dhënash.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi pretendimet e kontrolluesit si dhe provat e administruara vëren se:

- Kontrolluesi nuk ka një rregullore të brendshme për sigurinë e të dhënave personale që përpunon.
- Në kartelën e pacientit nuk u konstatua një pikë e veçantë në lidhje me detyrimin për informimin e pacientëve për fushën dhe qëllimin për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për mënyrën e përpunimit, për të drejtën për akses si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".
- Nuk ka plotësuar detyrimin për njoftim pranë Komisionerit, në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale". (Zbatimi i

këtij detyrimi të përmbushet sipas afatit të vendosur në proces-verbalin e mbajtur ditën e kontrollit administrativ).

Konstatimet e sipërme përbëjnë shkelje administrative të:

- Neni 27 pika 2/1 i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

“Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat tekniko-organizative të përshatatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin dhe rregulloret të tjera”

- Neni 18 pika 1 e Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

“kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin,.....”.

- Neni 21 pika 1 i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

“Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës....”.

Për sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative ;

REKOMANDOJ

1. Të dhënat personale nuk duhet të mbahen më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar. Të respektohen afatet e parashikuara në kreun III “Ruajtja e të dhënave shëndetësore” të Udhëzimit nr. 23, datë 20.11.2012 “Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin e shëndetësisë”.
2. Në zbatim të neneve 27 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të merren masa për hartimin e një rregullore të shkruar për mbledhjen, mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen e të dhënave personale. (Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare www.kndp.al, si dhe ofrojmë asistencën tonë).
3. Të bëhet ndryshimi në kartelën e pacientit duke u përfshirë një pikë e veçantë në lidhje me detyrimin për informimin e pacientëve për fushën dhe qëllimin për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për mënyrën e përpunimit, për të drejtën për akses si dhe të drejtën për korrigjimin të të dhënave të tij në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, ku citohet shprehimisht: *“kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin,.....”*, duke u

shoqëruar me të gjithë informacionin e kërkuar nga neni 13, si dhe Udhëzimi nr. 23, datë 20.11.2012 "Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin e shëndetësisë".

- 4- Kryerja e këtyre detyrimeve të rëndësishme të kryhet brenda një afati kohor prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, nga momenti i marrjes dijeni të këtij rekomandimi.
- 5- Me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- 6- Me kalimin e këtij afati në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas neni 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", sipas të cilit "*Komisioneri në rast shkelje h serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përp. nues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave*".

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

Blora ÇABEJ (POGAÇE)

